

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-26-4135-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimi për mirëmbajtje dhe përmirësime në Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK).**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

Tretek SH.P.K.

NUI

810853821

Adresa

Rr.Astrit Rrushi Obj.Pika Mati 1

Vendi

Prishtinë

Kodi postar

10000

Numri Telefonit

+38349642227

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj

Lirim Sulejmani

Adresa elektronike

tretekshpk@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës

29.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë – 03.06.2026
- Proces verbali i hapjes së Tenderëve – 29.06.2026
- Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 14.07.2026
- Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim – 20.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Jemi njoftuar përmes platformes elektronike të prokurimit publik me hapjen e tenderëve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Vendimi i autoritetit kontraktues në raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar. Te bashkangjitur në këtë ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste

Neni 27 - Dosja e Tenderit

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

REGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

Neni 4 - Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

Neni 17 - Dosja e Tenderit

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Bazuar në dispozitat e nenit 109(2) të LPP-së, parashtrojmë këtë **Ankesë** ndaj Vendimit të AK-së i pranuar nga OE me datën 14-07-2026 (**"Vendimi i Ankimuar"**) përmes së cilit është Refuzuar Kërkesa e datës 20-07-2026 në kuptim të së cilës është propozuar kthimi i tenderit në ri-vlerësim ashtu që pas rivlerësimit **Tretek SH.P.K.** t'i mundësohet qasje e plotë dhe e menjëhershme në dokumentacionin e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

TRETEK SH.P.K. ka kërkuar anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, për shkak se AK-ja nuk ka mundur qasje të ligjshme dhe efektive në dokumentacionin mbi të cilin është bazuar vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Në mënyrë të veçantë, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar versionet e pastruara të listës së kontratave, listës së stafit profesional dhe dëshmimeve përkatëse, ndonëse këto dokumente përbëjnë bazën kryesore për vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të CMD SH.P.K.

Pretendimet e paraqitura në këtë ankesë janë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim. Informacionet dhe provat shtesë të paraqitura në vijim shërbejnë vetëm për konkretizimin dhe mbështetjen e pretendimeve ekzistuese dhe nuk përbëjnë pretendime të reja ankimore.

I. RRETHANAT FAKTIKE DHE PROCEDURA

Pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së më datë 14.07.2026, TRETEK SH.P.K. ka kërkuar qasje në ofertën dhe dokumentacionin e dorëzuar nga CMD SH.P.K., OE i rekomanduar për dhënie të kontratës. Më datë 15.07.2026, Autoriteti Kontraktues na ka përcjellë përmes postës elektronike vetëm një pjesë të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar, duke na njoftuar si në vijim:

“Bashkëngjitur ju dërgojmë ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. Ju njoftojmë se nga oferta janë përjashtuar vetëm dokumentet që janë klasifikuar si sekret afarist, ndërsa pjesa tjetër e dokumentacionit ju vihet në dispozicion.”

Nga dokumentacioni i përcjellë janë përjashtuar pikërisht dokumentet që lidhen me përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, **përkatësisht lista e kontratave/projekteve, lista e stafit dhe dëshmitë përkatëse**. Për këtë arsye, po më datë **15.07.2026**, TRETEK SH.P.K. i'u është drejtuar edhe njëherë AK-së përmes postës elektronike (Ganimete.J.Shala@gjyqesori-rks.org) dhe ka kërkuar që t'i mundësohet shqyrtimi i dokumentacionit në zyrat e AK-së.

Në kërkesën tonë kemi sqaruar shprehimisht se qëllimi është vetëm të verifikohet:

- nëse dokumentet e kërkuara sipas DT janë dorëzuar nga CMD SH.P.K.; dhe
- nëse dokumentet e dorëzuara përputhen me kërkesat e përcaktuara në DT.

Gjithashtu, i kemi lënë AK-së mundësinë që vetë ta caktojë ditën dhe orën e shqyrtimit të dokumentacionit. Megjithatë, AK-ja **NUK** ka aprovuar kërkesën tonë dhe nuk na ka mundësuar qasje në dokumentacionin e kërkuar. Në vend të kësaj, kemi pranuar këtë përgjigje:

“Ne baze të rregullores NR..001/2022 për Prokurim Publik Neni 7 pika 7.4, Autoritet Kontraktues përveç dokumentave që janë sekret afarist të gjithë materialin tjetër të OE të rekomanduar për kontratë e keni pranuar në e-mail.”

Nga kjo përgjigje rezulton se AK-ja e ka refuzuar kërkesën tonë për qasje në dokumentet e klasifikuara si sekret afarist, pa dhënë arsyetim konkret lidhur me ligjshmërinë e klasifikimit të tyre dhe pa na ofruar versionet e pastruara të dokumenteve.

Provë: Korrespondenca elektronike ndërmjet TRETEK SH.P.K. dhe AK-së

II. PRETENDIMET ANKIMORE

1. Aneksi 3 - Sekreti afarist / jo-arsyetim konkret

Nga dokumentacioni i përcjellë mungojnë dokumentet për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave të DT, përkatësisht:

- lista e kontratave/projekteve të realizuara dhe dëshmitë përkatëse; dhe
- lista e stafit profesional dhe dëshmitë përkatëse.

Këto dokumente janë pjesë e kritereve të përcaktuara në DT (9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional) dhe përbëjnë bazën mbi të cilën AK-ja ka vlerësuar aftësinë teknike dhe profesionale

të operatorit ekonomik të rekomanduar.

Nga Aneksi 3 - “Kërkesa për sekret afarist”, i dorëzuar nga CMD SH.P.K., rezulton se operatori ka kërkuar që të klasifikohen si sekret afarist:

- “Lista e projekteve dhe dëshmitë nga kjo listë”;
- “Lista e stafit dhe dëshmitë nga kjo listë”.

Si arsyetim për klasifikimin e këtyre dokumenteve janë paraqitur vetëm formulimet:

- “Ruajtja e konkurrencës”; dhe
- “Mbrojtja e pronës intelektuale”.

Arsyetimet e mësipërme janë të përgjithshme, abstrakte dhe nuk demonstrojnë se si publikimi i secilit dokument konkret do t’i shkaktonte dëm material interesave legjitime komerciale të CMD SH.P.K.

Në kërkesën për sekret afarist nuk është sqaruar:

- cili informacion konkret në listën e projekteve ose kontratave përbën sekret afarist;
- cili informacion konkret në listën e stafit përbën sekret afarist;
- në çfarë mënyre lista e stafit ose përvoja profesionale përbën pronë intelektuale;
- çfarë dëmi material konkret do t’i shkactohej operatorit ekonomik;
- cila është lidhja ndërmjet zbulimit të dokumenteve dhe dëmtimit të pretenduar;
- pse nuk mund të mbulohen vetëm të dhënat personale ose pjesët eventualisht konfidenciale.

Sipas nenit 11, paragrafit 3 të LPP-së, një informacion mund të klasifikohet si sekret afarist vetëm kur kërkesa për klasifikim përmban arsye që demonstrojnë bindshëm se qasja publike në informacionin konkret do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik

Gjithashtu, sipas nenit 7.6.1 të Rregullores Nr. 001/2022, Autoriteti Kontraktues nuk duhet të klasifikojë një informacion si sekret afarist kur operatori ekonomik nuk ka paraqitur të gjitha faktet dhe argumentet me të cilat dëshmon se zbulimi i informacionit do t’i shkaktonte dëm material biznesit të tij.

Vetëm shënimi i dokumentit si “sekret afarist” dhe plotësimi formal i Aneksit 3 nuk mjaftojnë për ta klasifikuar automatikisht tërë dokumentin si sekret. AK-ja është dashur ta shqyrtojë dhe vlerësojë kërkesën e CMD SH.P.K. për secilin dokument dhe secilën pjesë të informacionit, e jo ta pranojë klasifikimin e plotë vetëm mbi bazën e dy formulimeve të përgjithshme.

Për këtë arsye, konsiderojmë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së dhe me nenet 7.5, 7.6 dhe 7.6.1 të Rregullores Nr. 001/2022.

2. Mosofrimi i dokumenteve në versione të pastruara

Edhe në rast se AK-ja do të konstatonte se pjesë të caktuara të dokumenteve përmbajnë informacione që duhet të mbrohen, kjo nuk e autorizon Autoritetin Kontraktues që t’i largojë dokumentet në tërësi nga dokumentacioni në të cilin kanë qasje palët e interesuara.

Sipas nenit 11, paragrafit 4 të LPP-së, kur një dokument përmban edhe informacione sekrete, edhe informacione që nuk janë sekrete, AK-ja është i obliguar të përgatisë një version të pastruar të dokumentit, duke larguar vetëm informacionet konkrete që janë klasifikuar ligjërisht si sekret afarist.

Sipas paragrafit 5 të të njëjtit nen, në rast se dokumenti përmban vetëm informacione të klasifikuara si sekrete, Autoriteti Kontraktues duhet të përgatisë së paku një përmbledhje të përgjithshme jo-sekrete të përmbajtjes së dokumentit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues:

- nuk na ka ofruar version të pastruar të listës së kontratave ose projekteve;
- nuk na ka ofruar version të pastruar të dëshmive për realizimin e kontratave;
- nuk na ka ofruar version të pastruar të listës së stafit;
- nuk na ka ofruar version të pastruar të CV-ve, diplomave, certifikatave, kontratave ose parakontratave të stafit;

Autoriteti Kontraktues ka mundur të mbulojë të dhënat personale ose informacionet eventualisht të ndjeshme, si:

- numrat personalë;
- adresat private;
- numrat e telefonit;
- nënshkrimet;
- pagat;
- të dhënat bankare;
- të dhëna të tjera personale që nuk lidhen me vlerësimin.

Megjithatë, nuk ekziston arsye që të mbulohen në tërësi të dhënat që janë të domosdoshme për verifikimin e kriterëve të DT, si:

- titulli dhe natyra e kontratës së realizuar;
- emri i klientit;
- vlera e kontratës;
- periudha e realizimit;
- përfundimi i suksesshëm i kontratës;
- emri dhe pozita e ekspertit;
- edukimi profesional;
- përvoja profesionale;
- certifikatat;
- pozita për të cilën është propozuar eksperti;
- ekzistenca e kontratës ose marrëveshjes së angazhimit.

Sipas nenit 7.6.2 të Rregullores, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet ta përgatisë versionin e pastruar menjëherë pas hapjes së ofertave dhe para publikimit të Formularit B58.

Sipas nenit 7.6.3, pas publikimit të B58-së, Autoriteti Kontraktues duhet t'i ofrojë palës së interesuar qasje të menjëhershme në versionin e pastruar dhe të mbajë procesverbal për qasjen.

3. Refuzimi i konsultimit të dokumenteve në zyrën e prokurimit (shikimi i dokumentëve)

Sipas nenit 10 të LPP-së, AK-ja është i obliguar që, me kërkesë me shkrim të një pale të interesuar, të sigurojë qasje të arsyeshme në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Qasja duhet të sigurohet në mënyrë të rregullt, të qetë dhe pa pengesa, ndërsa pala e interesuar ka të drejtë të marrë edhe kopje të materialeve në të cilat ka të drejtë qasjeje.

Sipas nenit 7.4 të Rregullores Nr. 001/2022, AK-ja duhet t'i ofrojë çdo pale të interesuar qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në dokumentacion, duke përfshirë konsultimin e dokumenteve në zyrën e prokurimit.

Me datën 15.07.2026, TRETEK SH.P.K. i është drejtuar Autoritetit Kontraktues përmes postës elektronike dhe **ka kërkuar që t'i mundësohet shqyrtimi i dokumentacionit në zyrat e Autoritetit Kontraktues.**

Në kërkesën tonë kemi sqaruar shprehimisht se qëllimi është vetëm të verifikohet:

- nëse dokumentet e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit janë dorëzuar nga CMD SH.P.K.; dhe
- nëse dokumentet e dorëzuara përputhen me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, i kemi lënë Autoritetit Kontraktues mundësinë që vetë ta caktojë ditën dhe orën e shqyrtimit të dokumentacionit. Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues përbën pengim të së drejtës për qasje dhe është në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të LPP-së, si dhe me nenet 7.4, 7.6.2 dhe 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022.

4. Pamundësimi i kontrollit efektiv të vendimit të AK-së

Lista e kontratave dhe dëshmitë për realizimin e tyre, lista e stafit dhe dëshmitë përkatëse nuk janë dokumente dytësore ose të parëndësishme.

Këto dokumente përbëjnë dëshmitë kryesore mbi të cilat Autoriteti Kontraktues është mbështetur për të konstatuar se CMD SH.P.K. i përmbush kriteret e aftësisë teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për shkak të mosfrimit të këtyre dokumenteve, TRETEK SH.P.K. nuk ka pasur mundësi të verifikojë:

- nëse kontratat e paraqitura janë të natyrës së kërkuar;
- nëse kontratat janë realizuar brenda periudhës së kërkuar;
- nëse është plotësuar vlera minimale e kërkuar;
- nëse janë dorëzuar dëshmi të pranueshme për përfundimin e suksesshëm;
- nëse stafi i propozuar i përmbush kualifikimet arsimore “Shkenca Kompjuterike”;
- nëse stafi e përmbush përvojën profesionale të kërkuar (minimumin e viteve);
- nëse janë dorëzuar certifikatat e kërkuara me emërtimin sipas DT;
- nëse ekspertët kanë kontrata, parakontrata ose marrëveshje të vlefshme të angazhimit (nënshkruar);

Pa qasje në këto dokumente, vendimi për rekomandimin e CMD SH.P.K. nuk mund të kontrollohet dhe verifikohet në mënyrë efektive nga pala e interesuar.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të mbështetet në dokumente tërësisht të fshehura për të konstatuar përmbushjen e kriterëve, pa e bërë të mundur që tenderuesit e tjerë të verifikojnë së paku informacionet jo-konfidenciale mbi të cilat është bazuar vendimi.

III. FAKTET QË MBËSHTESIN PRETENDIMET ANKIMORE

1. Mos-plotësimin e kriterit për Menaxherin e Projektit sipas DT

Nga dokumenti publik “**19. Formulari i tenderit.pdf**”, i ngarkuar nga CMD SH.P.K., rezulton se z. Arben Vllasa është propozuar në pozitën “Menaxher i Projektit”.

Në formularin publik të tenderit, dokumentacioni përkatës i personit të propozuar është identifikuar me titullin: “**8. Arben Vllasa – Menaxher i Projektit.pdf**”.

Provë: “19. Formulari i tenderit.pdf”.

Sipas kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit, për këtë pozitë është kërkuar:

“Diplomë universitare në fushën e shkencave kompjuterike ose certifikime profesionale nga platforma Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të të dhënave.”

Në kërkesën për rishqyrtim, TRETEK SH.P.K. ka pretenduar shprehimisht se, për shkak të refuzimit të qasjes në listën e stafit dhe dëshmitë përkatëse, nuk ka pasur mundësi të verifikojë nëse personeli i propozuar plotëson kualifikimin arsimor dhe profesional të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Pas refuzimit të qasjes, TRETEK SH.P.K. ka shqyrtuar informacionet publike në dispozicion.

Nga profili publik profesional i z. Arben Vllasa rezulton se ai ka përfunduar studimet në drejtimin **“Inxhinieri Kompjuterike”** pranë FIEK-ut. Gjithashtu, në informacionet publike të paraqitura në këtë profil **nuk evidentohet** posedimi i certifikimeve profesionale nga platforma Microsoft në fushën e zhvillimit të softuerit dhe administrimit të bazave të të dhënave, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

<https://www.linkedin.com/in/arben-vllasa/>

Education



University of Prishtina

Bachelor's degree, Computer Engineering

2009 – 2014

Kjo informatë paraqitet si rrethanë konkrete që krijon **nevojën për verifikimin** nga eksperti shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues të dokumentacionit të plotë të dorëzuar për këtë person.

Kërkesa e DT është formuluar në mënyrë të qartë: **diplomës universitare në fushën e shkencave kompjuterike ose certifikimeve profesionale nga platforma Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të të dhënave.**

Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieria Kompjuterike nuk janë i njëjti drejtim studimi. Edhe pse të dyja përmbajnë termin “kompjuterike” në emërtim, ato kanë programe, përmbajtje dhe orientim të ndryshëm akademik.

Shkencat Kompjuterike janë të orientuara kryesisht në programim, zhvillim të softuerit, algoritme, baza të të dhënave dhe sisteme informative. Ndërsa Inxhinieria Kompjuterike është drejtim inxhinierik, i lidhur me harduerin, elektronikën, arkitekturën e kompjuterëve dhe sistemet teknike.

Pra, ngjashmëria në emërtim nuk nënkupton se këto dy diploma janë të njëjta apo automatikisht të barasvlershme.

Në rastin konkret, Dosja e Tenderit ka kërkuar në mënyrë të qartë diplomë universitare **në fushën e Shkencave Kompjuterike ose certifikime profesionale nga platforma Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të të dhënave.**

Ndërsa, sipas informacionit publik në dispozicion, z. **Arben Vllasa** ka përfunduar studimet në drejtimin **“Inxhinieri Kompjuterike”** pranë FIEK-ut. Për këtë arsye, kjo diplomë nuk mund të konsiderohet automatikisht si përmbushje e kërkesës për Shkenca Kompjuterike vetëm për shkak se në emërtimin e saj përfshihet fjala “kompjuterike”.

Prandaj, eksperti shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues **duhet të verifikojnë** nëse dokumentacioni i dorëzuar përmban:

1. diplomë universitare **në fushën e Shkencave Kompjuterike**, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, **dhe jo** diplomë në drejtimin Inxhinieri Kompjuterike; ose
2. certifikime profesionale nga platforma Microsoft në zhvillimin e softuerit dhe administrimin e bazave të të dhënave.

Nëse nuk është dorëzuar asnjëra nga këto dëshmi, duhet të konstatohet se personi i propozuar nuk e plotëson kriterin e përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha shkeljet e lartpërmendura, **kërkojmë nga OSHP-ja që:**

I. Ta shpallë ankesën tonë të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që, në përputhje Ligjin për Prokurimin Publik dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurim Publik, të anulojë vendimin e mëparshëm dhe të ftojë Tretak SH.P.K. për nënshkrimin e kontratës si operatori ekonomik me ofertën më të përgjegjshme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës dhe ankesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.
- **Fitimet e pritura:** Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka rezultuar në humbjen e mundësisë për të realizuar këto fitime.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) 1.Aneksi 2 & 3 CMD SHPK (1).pdf
- i) Korrespondenca elektronike ndërmjet TRETEK dhe AK.pdf
- j) 19.Formulari i Tenderit.pdf

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.